

1826



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	23.02.2024
Referenc-ë	<p>Nr. i prokurimit 616-23-4190-5-1-1</p> <p>Nr i brendshëm 616 23 093 511</p> <p>Titulli: Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet</p>
Për/ Za/ To:	Përparim Rama Zyrtar Kryesor Administrativ
Nga/ Od/ From:	Visar Shehu U.D Udhëheqës I Departamentit të Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject:	KONTRATA

Titulli: „ Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet

Gjeni te bashkangjitur kontratën e cila është dorëzuar për e nënshkrim me datën 22.06.2023 sipas librit te protokollit te Prokurimit 1106.

Me respekt

Departamenti i Prokurimit !



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

616-23-4190-5-1-1

Data: 22 / 06 / 2023

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë, dhe

"Grup i Operatorëve Ekonomik SELMANS NETWORK SH.P.K.; Infra-Plus SH.P.K.Lagja Spitalit, Rr. Jakov Xoxa, Kompleksi Blini, Co, pn., PRISHTINË, regjistrimin e biznesit unik 810815061 e përfaqësuar nga Betim Selmanaj- Drejtor , në tekstin e mëtejme ("Kryesi i punëve"), janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për punët të shënuara me poshtë:

Titulli: „Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet”

Nr i prokurimit	616-23-4190-5-1-1
Nr i brendshëm	616 23 23 093 511

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim: **Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon për 36 MUAJ.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë 5 ditë kalendrike nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë ne IEA .

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikativë(Vlera e parashikuar) e kontratës është 1.200.000,00 Euro.(Një milion e dyqinde mije euro e zero euro cent) çmimi total i poentuar është 4,281.18€.

Duke qenë se në këtë Kontratë, në pajtim me dispozitat e nenit 52 pika 6 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092LPP-së dhe nenin 56 pika 11 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik nuk është përcaktuar ndonjë limit financiar dhe / ose sasior apo devijim i lejuar nga vlera e parashikuar e kontratës, Menaxheri i Kontratës duhet ta arsyetoj bindshëm tejkalimin e shpenzimit të vlerës së parashikuar të Kontratës ne rast se vlera e parashikuar ndryshon në mënyrë substanciale.

Peshimi i artikuj-ve duhet bërë bazuar në peshën dhe ne rëndësinë e kategorisë përkatëse, qe do te thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës se dhënë ne Dosjen e Tenderit. Menaxheri i Kontratës mbetet përgjegjëse që të dëshmoj ne mënyrë te qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale te Autoritetit Kontraktues

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet






5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të

shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues				Për Kontraktuesin	
Drejtor i prokurimit		Zyrtari Kryesor Administrativ			
Emri:	Visar Shehu	Emri:	Përparim Rama	Emri:	Defim Selmanaj
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	Kryetar i Komunës	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.06.2023	Data:		Data:	22.06.2023
Vula:				Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **“Punë”** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **“Kontraktuesi”** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **“Menaxheri i Projektit”** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **“Çmimi Kontratës”** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **“Vendi i ndërtimit”** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **“Pajisjet e kontraktuesit”** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **“Skicat”** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **“KPK”** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk nje lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet të kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do të jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, të kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e

kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren; dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të

ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

17.2 Kontraktuesi do të ekzekutoj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin

Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Kontraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e kontraktuesit.

19.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi i gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimi do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitohet menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Parimet e përgjithshme të pagesave

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shumën e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shumën që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shumën proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shumën, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

27.2 Shumën e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do të dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do të kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet të paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në

detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaraten e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaraten e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaraten e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaraten e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % vlerës së parashikuar (120.000,00€) për kohëzgjatjen e periudhës prej 37 muajve .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë


		kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit te kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [shëno numrin] ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Kërkesat për pagese do të bëhen për punët e përfunduara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për punët e përfunduara ne baza mujore (ex post). Ne baze te konstatimit te Menagjerit dhe ekipit mbikëqyrës. Nuk ka pagese paraprake
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve (3vite).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite.
Pagesa shkëputjes pas së	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e


kontratës		vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

NDËRTIMI I RRETHOJAVE PËR SIGURI NË MOBILITET					
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma me TVSH
					A: Totali I (60% e përkësive të vlerësimit)
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i kornizave parkimi për blloqet sipas dimensioneve minimale: Pjesa nga betoni L: 1000 mm B: 550 mm H: 260 mm Peshë: 85 kg. me 4 bulona M10. Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose granit (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX. Përzierja e polirit zgjidhet nga organi mbikëqyres (e bardhë, kaft, hirt, e zezë etj). Me mbulesë Varnish-gloss sipas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezionit sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1-2004, EN10025:2004). Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidrorollimi sipas standardit EN206:2021. Rezistenca ndaj ngjirave sipas standardit EN206:2021, Figura 1	copë	1	987.12	987.12 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritave me Ø300mm, h=380 të tokës sipas karakteristkëve: Me mbrojtje zIP67, temperatura ≥3000K, fuqia ≥11W, materiali nga Giza EN1561, nano-optika në PMMA me reflektor të drejtpërdrejtë me shkëlqim të ulët, poliamid PA66 PG16 Ø 14mm MAX IP 68, çeliku inox AISI 304 Flanxha: çeliku 5235 i galvanizuar i nxehët dhe i veshur me pluhur Gothda për tokë - çeliku inox AISI 304. Figura 2	copë	1	1173.85	1,173.85 €
3	Furnizimi dhe montimi i shtyllave antipark si në nga materiali polimer, i cili përmban edhe shiritin Retro-reflektues me grimca fosforit, me peshë minimum 10kg me gjatësi minimum 45cm dhe gjerësi të bazës minimum 25x25cm. Ngjyra përcaktohet nga organi mbikëqyres. Në pozicion të parashihet edhe: Furnizimi me material, kallëpimi dhe punimi i themellit të parafabrikuar (40x40x50 nga betoni C25/30) i lidhur për shtyllë gjatë fazës së parafabrikimit (në beton të njo). Procesi duhet të përfshijë bulonat M12, dadot që kontaktojnë direkt me bazën e shtyllës nga ana e poshtme dhe pllakën shiritore me gjerësi 10cm e cila lidh të gjithë bulonat në nivel 15cm nën bazën e shtyllës. Para montimit të shtyllës duhet të përgatitet baza (nivëlizohet dhe ngjeshet). Pas vendosjes së shtyllës, hapësira përreth bazamentit të parafabrikuar duhet të mbushet me zhavor dhe të ngjeshet. Figura 3	copë	1	125	125.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i shtyllave antipark si në nga materiali polimer, i cili përmban edhe shiritin Retro-reflektues me grimca fosforit, me peshë minimum 12.5kg me gjatësi minimum 70cm dhe gjerësi të bazës minimum 28x28cm. Ngjyra përcaktohet nga organi mbikëqyres. Në pozicion të parashihet edhe: Furnizimi me material, kallëpimi dhe punimi i themellit të parafabrikuar (40x40x50 nga betoni C25/30) i lidhur për shtyllë gjatë fazës së parafabrikimit (në beton të njo). Procesi duhet të përfshijë bulonat M12, dadot që kontaktojnë direkt me bazën e shtyllës nga ana e poshtme dhe pllakën shiritore me gjerësi 10cm e cila lidh të gjithë bulonat në nivel 15cm nën bazën e shtyllës. Para montimit të shtyllës duhet të përgatitet baza (nivëlizohet dhe ngjeshet). Pas vendosjes së shtyllës, hapësira përreth bazamentit të parafabrikuar duhet të mbushet me zhavor dhe të ngjeshet. Figura 4	copë	1	175	175.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllës kubike nga betoni-sipas dimensioneve minimale: Dimensionet gjenerale L: 380 mm B: 380 mm H: 400 mm Peshë: 130 kg Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose granit (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar dhe stampuar. Stampimi i llogos (hyjnesha në fron me përshkrim Komuna e Prishtinës) nga materiali INOX. Përzierja e polirit zgjidhet nga organi mbikëqyres (e bardhë, kaft, hirt, e zezë etj). Me mbulesë Varnish-gloss sipas standardit EN 1504-2). Rezistenca ndaj korezionit sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1-2004, EN10025:2004) Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019. Hidrorollimi sipas standardit EN206:2021. Rezistenca ndaj ngjirave sipas standardit EN206:2021, Figura 5	copë	1	515	515.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave antipark GMR-Arona ose e ngjashme me dimensione 1000xØ180mm me materiale shtesë unaza për fiksion të shigjërëve me peshë 20kg nga çeliku inox AISI 304. Figura 6	copë	1	340	340.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave antipark GMR-3000P ose e ngjashme me dimensione 800xØ145mm me materiale shtesë unaza për fiksion të shigjërëve me peshë 14.5kg nga çeliku inox AISI 304. Figura 7	copë	1	307	307.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave antipark GMR-Ciro ose e ngjashme me dimensione 1000xØ120mm me materiale shtesë unaza për fiksion të shigjërëve me peshë 15.5kg nga çeliku inox AISI 304. Figura 8	copë	1	135	135.00 €
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave antipark GMR-Zn 170 ose e ngjashme me dimensione 1000xØ122mm me materiale shtesë unaza për fiksion të shigjërëve me peshë 15.5kg nga çeliku inox AISI 304. Figura 9	copë	1	308	308.00 €
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave antipark GMR-Onda ose e ngjashme me dimensione 780xØ248mm me materiale shtesë unaza për fiksion të shigjërëve me peshë 20kg nga çeliku i galvanizuar. Figura 10	copë	1	602	602.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i litarit nga metali antikoroziues, adekuat për shtyllat antiparkim për kufizim dhe pjesë tjera. Ngjyra zgjidhet nga organi mbikëqyres.	m'	1	10	10.00 €
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i skajorëve LED me specifkime: dimensionet 500x200x150mm, materiali PE, 2 pjesë LED mbienda, ngjyra zgjidhet nga organi mbikëqyres, orë e punës 5000h, mbrojtja IP68, trashësia e materialit 6mm, përballim i ngarkesës deri në 800kg, temperatura -75°C deri në 110°C, tensioni 12V, peshë 2kg, garancioni për material 3 vite kurse për LED, 1 Vit. Figura 11	copë	1	90	90.00 €
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i murit të parafabrikuar L me dimensione 55x30x100cm, t=12cm me të gjitha materialet në figurën 12.	copë	1	150	150.00 €
14	Furnizimi, transporti dhe montimi i murit të parafabrikuar L me dimensione 80x50x100cm, t=12cm me të gjitha materialet në figurën 13.	copë	1	180	180.00 €
15	Furnizimi, transporti dhe montimi i murit të parafabrikuar L me dimensione 130x80x100cm, t=12cm me të gjitha materialet në figurën 14.	copë	1	300	300.00 €
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i bllok model të parafabrikuar me dimensione 100x50x50cm, me të gjitha materialet në figurën 15.	copë	1	245	245.00 €
17	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakës model të parafabrikuar me dimensione 100x105x12cm, me të gjitha materialet në figurën 16.	copë	1	150	150.00 €
18	Punimi i bazamentit për muret e parafabrikuar L nga 55, 80, 100, 130 dhe 105 me materialin si në vijim: -Mbushja e bazamentit me zhavor 0.16cm -Presimi (ngjeshja e zhavorit 0.16cm) -Nivëlizimi me zhavor 0.02cm dhe 1/4 cement -Vendosja e murit vinkel -Pjesa horizontale e murit vinkel ku mbushet fugat me beton.	m'	1	35	35.00 €
19	Gërmimi i dheut të kategorisë III dhe IV për hapjen e themeleve. Në këtë pozicion përfshihet kthimi dhe ngjeshja e dheut pas punimit të themeleve dhe transporti i materialit të tepërt në depo.	m ³	1	25	25.00 €
20	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksionuar-zhavor 0-64mm t=20cm dhe ngjeshja e tij, me makina përkatëse.	m ³	1	31	31.00 €
21	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksionuar-zhavor 0-31.5mm t=10cm dhe ngjeshja e tij, me makina përkatëse me ngjeshmëri M=200kg/cm ² .	m ³	1	33	33.00 €
22	Furnizimi, transporti përgaditja e bazës me rërë me gurë të 0-4mm.	m ³	1	21	21.00 €
23	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së slierit	m ²	1	25	25.00 €
24	Prezja e betonit, largimi i betonit me dim (0.20x0.25)m me transport deri në depo, si dhe kthimi në gjendje të mëparshme (betonimi). Llogaria të kryhet për m ³	m ³	1	35	35.00 €
25	Largimi i kubave me transport në trotuare dhe rrugë si dhe kthimi në gjendje të mëparshme (vendosja e kubave).	m ³	1	18	18.00 €
26	Prezja e asfaltit apo shpimi, largimi i asfaltit me dim (0.20x0.14)m me transport deri në depo, si dhe kthimi në gjendje të mëparshme (asfaltimi). Llogaria të kryhet për m ³	m ³	1	31	31.00 €
				Totali A:	6,046.97 €

				B: Total I (40% e përkryer për vlerësim)	
27	<p>Furnizimi me material, punimi dhe montimi i rrethojës së "tipit 1" si në detajet e bashkangjitura. Një panel i rrethoja përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbajësit kryesor me prerje tërthore Ø60x3mm me dimensione si në detajet për rrethojën e tipit 1; -Shufrat mbushëse me prerje tërthore Ø20x2mm (14 copë); -Pllakat për ankerim 250x250x15mm (4copë) derisa për rastet kur rrethoja ekzekutohet mbi mur ekzistues (2copë); -Ankerët me gjatësi më të madhe se 30cm (8copë) me nga dy dado për secilin, si dhe -Themelët nga betoni me dimensione 45x45x35 dhe 56x45x35 si në detaje për rrethojën e "tipit 1" (të cilët ekzekutohen vetëm për rastet kur rrethoja nuk ekzekutohet mbi mur). <p>Në rastet kur rrethoja nuk ekzekutohet mbi mur ekzistues në pozicion duhet të parashihet edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Prerja e konstruksionit e shtrësës qarkulluese të hapësirës ku parashihet të punohet themell i rrethojës dhe demolimi i saj; -Gërmimi i shtrësave tjera për ekzekutimin e themellit; -Pastrimi i sipërfaqes, ngarkimi i mbeturinave ndërtimore dhe ato nga gërmimi, transportimi dhe deponimi i tyre në deponi të licencuar. <p>Vërejtje:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pllaka e epërme ankeruese duhet të jetë e salduar për shtyllat e rrethojës; -Pllaka e poshtme ankeruese duhet të vendoset në beton të njom (të cilët vendosen vetëm për rastet kur rrethoja nuk ekzekutohet mbi mur); -Të gjitha saldimet duhet të realizohen me CO2 sipas standardeve të parapara për këtë lloj saldimi; -Të gjitha saldimet dhe përpunimi sipërfaqësor i tyre duhet të bëhet para lyerjes; -Lyerja duhet të realizohet me plastifikim; -Ngjyra përcaktohet nga Organi mbikëqyrës; -Për rastet kur rrethoja ekzekutohet mbi mur nuk ka nevojë të realizohen themelet mirëpo duhet të parashihet shpimi i murit për fuqjen e ankerve dhe sillkoni adekuat për ankerim apo edhe elemente tjera për të siguruar në ankerim adekuat; -Distanca në mes të paneleve të rrethojës duhet të jetë 5 deri në 10cm; -Nëse për shkak të specifikave të lokacionit rrethoja duhet të punohet me gjatësi më të vogël se ajo e parapara në detaje, distanca në mes të shufrave vertikale mbushëse duhet të ruhet; -Çmimi duhet të jepet për një metër gjatësi të rrethojës. 	copë	1	260	260.00 €
28	<p>Furnizimi me material, punimi dhe montimi i rrethojës së "tipit 2" si në detajet e bashkangjitura. Një panel i rrethoja përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shtyllat me prerje tërthore 80x60x2.5mm (2copë); -Traversat me prerje tërthore 60x40x2.5mm (2copë); -Shufrat mbushëse që formojnë formën "X" me prerje tërthore 60x40x2.5mm të cilat lidhen mes tyre përmes pllakës shiritore me trashësi të 8mm dhe gjërësi 60mm të lakuar për të formuar rrethin me diametër 14cm; -Pllakat për ankerim 250x250x15mm (4copë); -Ankerët me gjatësi më të madhe se 30cm (8copë) me nga dy dado për secilin, si dhe -Themelët nga betoni me dimensione 45x45x35 dhe 61x45x35 si në detaje për rrethojën e "tipit 2". <p>Në pozicion duhet të parashihet edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Prerja e konstruksionit e shtrësës qarkulluese të hapësirës ku parashihet të punohet themell i rrethojës dhe demolimi i saj; -Gërmimi i shtrësave tjera për ekzekutimin e themellit; -Pastrimi i sipërfaqes, ngarkimi i mbeturinave ndërtimore dhe ato nga gërmimi, transportimi dhe deponimi i tyre në deponi të licencuar. <p>Vërejtje:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pllaka e epërme ankeruese duhet të jetë e salduar për shtyllat të rrethojës; -Pllaka e poshtme ankeruese duhet të vendoset në beton të njom; -Shtyllat në pjesën e epërme duhet të jetë e mbyllur me pllakë metalike të salduar në shtyllë në të gjithë perimetrin; -Të gjitha saldimet duhet të realizohen me CO2 sipas standardeve të parapara për këtë lloj saldimi; -Të gjitha saldimet dhe përpunimi sipërfaqësor i tyre duhet të bëhet para lyerjes; -Lyerja duhet të realizohet me plastifikim; -Ngjyra përcaktohet nga Organi mbikëqyrës; -Distanca në mes të paneleve të rrethojës duhet të jetë 10 deri në 20cm; -Çmimi duhet të panel të montuar. 	copë	1	220	220.00 €
29	<p>Furnizimi me material, punimi dhe montimi i rrethojës së "tipit 3" si në detajet e bashkangjitura. Një panel i rrethoja përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shtyllat me prerje tërthore 60x40x2.5mm (2copë); -Traversat me prerje tërthore 40x40x2.5mm (2copë); -Shufrat mbushëse që formojnë formën "X" me prerje tërthore 40x40x2.5mm të cilat lidhen mes tyre përmes pllakës shiritore me trashësi të 8mm dhe gjërësi 60mm të lakuar për të formuar rrethin me diametër 14cm; -Pllakat për ankerim 250x250x15mm (4copë); -Ankerët me gjatësi më të madhe se 30cm (8copë) me nga dy dado për secilin, si dhe -Themelët nga betoni me dimensione 45x45x35 dhe 61x45x35 si në detaje për rrethojën e "tipit 3". <p>Në pozicion duhet të parashihet edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Prerja e konstruksionit e shtrësës qarkulluese të hapësirës ku parashihet të punohet themell i rrethojës dhe demolimi i saj; -Gërmimi i shtrësave tjera për ekzekutimin e themellit; -Pastrimi i sipërfaqes, ngarkimi i mbeturinave ndërtimore dhe ato nga gërmimi, transportimi dhe deponimi i tyre në deponi të licencuar. <p>Vërejtje:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pllaka e epërme ankeruese duhet të jetë e salduar për shtyllat të rrethojës; -Pllaka e poshtme ankeruese duhet të vendoset në beton të njom; -Shtyllat në pjesën e epërme duhet të jetë e mbyllur me pllakë metalike të salduar në shtyllë në të gjithë perimetrin; -Të gjitha saldimet duhet të realizohen me CO2 sipas standardeve të parapara për këtë lloj saldimi; -Të gjitha saldimet dhe përpunimi sipërfaqësor i tyre duhet të bëhet para lyerjes; -Lyerja duhet të realizohet me plastifikim; -Ngjyra përcaktohet nga Organi mbikëqyrës; -Distanca në mes të paneleve të rrethojës duhet të jetë 10 deri në 20cm; -Çmimi duhet të panel të montuar. 	copë	1	205	205.00 €
30	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i dritës TRIF për skajore sipas specifikimeve:Ngjyra 3000K/4000K/RGB/R/G/B, fuqija 2.5W, DC 12/24, 260lm, CRI>85, IP69, IK10, temp -60°C/+50°C, materiali nga çeliku inox dhe pleksiglas, kablo, bulona me të gjitha materialet shtesë deri në montim dhe lëshim në punë Figura 23.</p>	copë	1	195	195.00 €
31	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave Terrazzo Terrastone ose e ngjajshme, me dimension 40x40x6 cm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngjyre sipas organit mbikëqyrës • Tekstura e vrazhde • E rrezuar dhe e impregnuar.Sipas përshkrimit teknik, Figura 17 	m ²	1	65	65.00 €
32	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave Terrazzo Terrastone ose e ngjajshme , kuarc me dimension 60x40x6 cm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngjyre sipas organit mbikëqyrës • Tekstura e vrazhde • E rrezuar dhe e impregnuar. & Chamfer.Sipas përshkrimit teknik, Figura 18 	m ²	1	65	65.00 €
33	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave Terrazzo Terrastone ose e ngjajshme, kuarc, bazalt ose granit me dimension 60x20x6 cm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngjyre sipas organit mbikëqyrës • Tekstura e vrazhde • E rrezuar dhe e impregnuar.Sipas përshkrimit teknik, Figura 19 	m ²	1	65	65.00 €
34	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave alfabetit për të vërbër (shiko drejt, fundi i rrugës, stop rrezik, pengesë rrezik.Sipas përshkrimit teknik, Figura 20</p>	m ²	1	55	55.00 €
35	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave Wash Beton River Pebble me dimension 40x40x6 cm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngjyra sipas organit mbikëqyrës • Tekstura e vrazhde • E rrezuar dhe e impregnuar.Sipas përshkrimit teknik, Foto 21 	m ²	1	65	65.00 €
36	Furnizimi, transporti dhe montimi i distancerave t=3mm D1	copë	1	1.5	1.50 €
37	Furnizimi dhe mbushja e fugeve me material HUESLER apo BAUMIT travertine per perdorim te jashtem me efekt drenues duke mos lejuar rritjen e bartje dhe duke perforcuar plaken me njera tjetren. Gjerësia e fuge duhet te jete >=3 mm.	kg	1	12	12.00 €

38	Përpunimi i tehut të shkallëve (Chamfer, Fillet) me të gjitha materialet shtesë për përfundim.	m ²	1	30	30.00 €
39	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e likoid impregneues, rezistent ndaj njollave dhe papastërtive, fluoroshences, dheut gjatë montimit të pllakave, pllqjeve nga ushqimet dhe vajrat, formacionet të myshqeve dhe algave, moll, humbjes së ngjyrës, rrezete UV si dhe ECO lehtë i pastureshëm.	litër	1	20	20.00 €
40	Demolimi i skajoreve ekzistues, transportimi dhe deponimi i tyre në deponi të licencuar. Taksat eventuale të deponimit i bartë punëkryesi.	copë	1	10	10.00 €
41	Furnizimi, transporti dhe vendosja e anësorëve/ ndarje fizike prej materialit të kombinuar beton granit Anësoret duhen të jenë rezistenc ndaj njollash impregnim, në pjesë integrale e sipërfaqes së ansore që mundeson mirebatjen e tyre me të fete, duhen të jenë rezistente ndaj kushteve klimatike, nga godtja e mjeteve motorike etj. Vendosja e tyre duhet të jete e vendosur të ankeruara dhe përforcuar në mënyrë profesionale, bazë mbi sipërfaqen e rrugës. Ngjyra do të përcaktohen nga Komuna.Dimensionet 8/20 Vërejtje: Gjatë ekzekutimit të punimeve, duhet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm, për sigurim të vendpunishtes në rrugë dhe sinjalizim adekuat konform lejisllacionit në fuqi.Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	1	18	18.00 €
42	Furnizimi, transporti dhe vendosja e anësorëve/ ndarje fizike prej materialit të kombinuar beton granit Anësoret duhen të jenë rezistenc ndaj njollash impregnim, në pjesë integrale e sipërfaqes së ansore që mundeson mirebatjen e tyre me të fete, duhen të jenë rezistente ndaj kushteve klimatike, nga godtja e mjeteve motorike etj. Vendosja e tyre duhet të jete e vendosur të ankeruara dhe përforcuar në mënyrë profesionale, bazë mbi sipërfaqen e rrugës. Ngjyra do të përcaktohen nga Komuna.Dimensionet 18/24 Vërejtje: Gjatë ekzekutimit të punimeve, duhet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm, për sigurim të vendpunishtes në rrugë dhe sinjalizim adekuat konform lejisllacionit në fuqi.Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	1	22	22.00 €
43	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve 10/20 prej M8 40 në bazën e betonit M8 20 d=20cm. Në cmim të logariten skajoret, betoni, aditivet hidrostop apo të ngjashëm, puna dhe shqyrtimet laboratorike për skajor në shtypje dhe në ngrirje. Atestet duhet të bëhen në prezencën e organit mbikqyrës.Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	1	19	19.00 €
44	Furnizimi transporti dhe vendosja e skajoreve 18/24/100 prej M8 40 në bazën e betonit M8 20 d=20cm. Në cmim të logariten skajoret, betoni, aditivet hidrostop apo të ngjashëm, puna dhe shqyrtimet laboratorike për skajor në shtypje dhe në ngrirje. Atestet duhet të bëhen në prezencën e organit mbikqyrës.Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	1	22	22.00 €
45	Furnizimi, transporti dhe montimi i formave për kullzim të pemëve rezistent nga korezioni, zjarri dhe ndryshku, ngjyra rezistent ndaj UV që nuk zbehet me dimensione 21000x1000x50 me diametër 500 dhe peshë 22kg.Ngjyra zgjidhet nga organi mbikqyrës. Figura 22	copë	1	85	85.00 €
46	Furnizimi transporti dhe vendosja e skajoreve 30/50/100 prej M8 40 në bazën e betonit M8 20 d=20cm. Në cmim të logariten skajoret, betoni, aditivet hidrostop apo të ngjashëm, puna dhe shqyrtimet laboratorike për skajor në shtypje dhe në ngrirje. Atestet duhet të bëhen në prezencën e organit mbikqyrës.Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	1	39	39.00 €
47	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e betonit C30/37, duka përfshirë kallëpimin.	m ³	1	150	150.00 €
48	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturave të brinjëzuarra S-500 me diametër Ø10mm.	kg	1	3	3.00 €
49	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturave të brinjëzuarra S-500 me diametër Ø12mm.	kg	1	3	3.00 €
50	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturave të brinjëzuarra S-500 me diametër Ø16mm.	kg	1	3	3.00 €
Totall B:					1,632.50 €
REKAPITULLIM					
A - Gjithsej (1-26):60%		Cmimi total		Cmimi total i peshuar	
		€ 6,049.97		€ 3,628.18	
B - Gjithsej (27-50):40%		€ 1,632.50		€ 653.00	
Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.				€ 4,281.18	





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 122674

Për Kuvendi i Komunës së Prishtinës

(Emri i Autoritetit Kontraktues)

Në emër të Selmans Network SH.P.K.

(Emri dhe adresa "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet**

Nr. prokurimit: 616-23-4190-5-1-1, Nr. brendshëm: 616-23-23/093-511

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarre veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke luajtur referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar të i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **120,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përfundimi i njërit nga kushtet në vijim:


- a. Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmiave të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka deshtuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbijljet e kontratës në fjalë, dhe
- b. Operatori ekonomik ka deshtuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe shrezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punetore, nënkontraktore dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e lartuar prej **120,000.00€** s'është lartcekur, pa pasur nevojë të verifikoni apo të tregoni arsye të ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1126 ditë kalendarike prej **28.02.2024** deri më **30.03.2027**

Data lëshimit: 01.05.2024

Nënshkrim dhe vulë e garantuesit



Ky garacion i nënshtrohet rregullave uniforme për garacione (URBG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



**SIGURIMI I OBJEKTEVE NË
 NDËRTIM DHE MONTIM**

I siguruarit/ Insured:	Semans Network SH.P.K.	Numri i polices/ Policy nr:	1206
Nr biznesit/ Business nr:	810815061	Ndërmjetësuesi/ Intermediary:	Lirina Morina
Nr fiskal/ Fiscal nr:	810815061	Kodi/ Agent code:	2072
Adresa/ Address:	Rruga Jakov Xoxa, Kompleksi Bini, Co, pn, Prishtinë	Përfutues/ Benefitor:	Kuvendi i Komunës së Prishtinës
Telefoni/ Phone:	045644544	Adresa përfutuesi/ Benefitor address:	Prishtinë
Përfutësuesi/ Representative:	Beim Selmanaj	Nënkontraktuesi i punimeve/ Subcontractor works:	Semans Network SH.P.K.

Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë llojë sigurimi.
 The insurance company and the policy holder vulnerably and with the good will sign this type of insurance.

Objekti i sigurimit/ Object insurance:	120,000.00	Lokacioni i rrezikut/ Risk location:	Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet
Implantet dhe pajisjet e ndërtimit/ Construction plant and equipments:	0.00	Numri i prekurimit/ Procurement number:	616-23-4190-5-1-1
Makinëritë e ndërtimit/ Construction machinery:	0.00	Data fillimit/ Begin date:	28.02.2024
Pastiri i mbeturinave/ Waste management:	0.00	Data mbarimit/ End dates:	30.03.2027
		Nr i ditëve/ Number of days:	1126

Rreziqet e siguruarat:
 (Zjarri dhe goditja e rrafesë, eksplodimi, shtrëngata, shu, lëshërit, derdhja e ujit nga cypat, orteqet e bores, acari, pasha e bores, akulli, shemija dhe ulja e tokës, fatkeqësitë ndërtimore, pakujdesia e punëtorëve, vjedhja me thyerfaqërat nëntokësore, goditja e mjefit motorik dhe rënja e gjërave të siguruarat në objektin e siguruar (plus rreziqet plotësuese)) = ALL RISK CAR/EAR.

Rreziqet plotësuese:
 Vëshitimi dhe rrëqejat: Jo, Rrëshqitja e tokës: Jo
 Përgjegjësia e kryesit të punëve ndaj palës së tretë: Jo
 Përgjegjësia e kryesit të punëve ndërtimore në afatin e kontraktuar: Jo
 Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së tretë për person: 50,000.00, për gjëra: 15,000.00, për përgjithshme: 65,000.00
 Third party liability for insured person: 50,000.00, for things: 15,000.00, in general: 65,000.00

Shuma total e siguruar/Insured coverage: 120,000.00 € **Shuma siguruar me tjetër: NJË DY ZERO ZERO ZERO ZERO**

Neto: 979.02 € **Tvsh: 176.22 €** **Bruto: 1,155.24 €**

Franshiza/ franchise: 10%; Franshiza në shumën minimale/ franchise at minimal value: 2,000 €

Primi paguhet menjshërë ose me kështë sipas marrëveshjes së arritur mes dy palëve e oia do të jetë pjesë përbërëse e polices.
 Premium must be paid immediately or will installments according to agreement arrived between, and the agreement will be part of policy.

Sigurimi është kontraktuar sipas ofertes (pyetësori) me shtikim të paraqitur nga i siguruari, kushteve të përgjithshme për sigurimin e pasurisë, kushteve për sigurimin e objekteve në ndërtim, kushteve të sigurimit të pajisjeve në montim dhe kushteve të sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe janë pjesë përbërëse të polices. This insurance contract is done according to general condition for property, according to CAR / EAR insurance and some supplemental risks, which are delivered to the policyholder and are policy components.

Vërejtje

Data e kështimit: 01.03.2024

Kompania e Sigurimeve Elsig I Siguruarit

Lirina Morina - 2072 Semans Network SH.P.K.